



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
2-D/DPK	01-1996/15
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
	21-07-2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.07.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 – 02-390/15, për z. Afrim Loku, Dekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02 - 390/15, për zyrtarin e lartë Afrim Loku, Dekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Loku është hetuar për konflikt interesi për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit të Dekanit, është edhe anëtar i Bordit në Postën e Kosovës (PTK).

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) i ka dërguar z. Loku njoftimin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

Në takim ai është njoftuar për kufizimet në ushtrimin e funksionit në PTK, krahas funksionit të Dekanit dhe ka premtuar do të shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të dispozitave të Ligjit PKI zyrtari i lartë ka të drejtë t'i ushtroj dy funksionet e lartpërmendura mirëpo nuk ka të drejtë pagese në ndërmarrjen publike.

Në nenin 15 (pika 2) të këtij Ligji përcaktohet se:

Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

Bazuar në këtë z. Loku ka njoftuar Agjencinë se ka filluar procedurat për t'u larguar nga pagesa në PTK. Kjo është konfirmuar edhe nga zyrtarët përgjegjës të PTK-së të cilët kanë njoftuar AKK-në se z. Loku tani nuk merr asnjë kompensim nga ky institucion. Andaj, me këtë është shmangur situata e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

